



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0080
Data e Vendimit: 10.02.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Mobelland" SH.P.K. kundër njoftimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me inventar për nevojat e MPB-se" me numër prokurimi 214-25-11592-5-5-8, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Ministria e Punëve të Brendshme, Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 10.02.2026, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtëafatshme ankesa e OE "Mobelland" SH.P.K me nr. të protokollit 2026/0080, e datës 06.02.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me inventar për nevojat e MPB-se" me numër prokurimi 214-25-11592-5-5-8, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësi të AK-së, pasi që kërkesa për rishqyrtim e OE ankues është parashtruar në kundërshtim me nenin 60 par të Rregullores .

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Ministria e Punëve të Brendshme që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 06.02.2026, ka pranuar ankesën e OE "Mobelland" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar për

nevojat e MPB-se” me numër prokurimi 214-25-11592-5-5-8, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësi të AK-së.

Me 05.02.2026, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka dërguar ftesën për ofertim OE "Mobelland" SH.P.K. AK ka planifikuar hapjen e ofertave me datën 09.02.2026.

OE "Mobelland" SH.P.K me datën 05.02.2026 në ora (17:16) që i bie me dt. 06.02.2026 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim.

Operatori Ekonomik "Mobelland" SH.P.K me datën 06.02.2026, ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokolli 0080/2026.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 09.02.2026 është planifikuar hapja e ofertave ndërsa OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar me datën 06.02.2026.

OSHP sqaron se sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues është jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores për Prokurimin Publik pasi që kërkesa është parashtruar me 06.02.2026, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën e lartcekur.

-Përfundim-

Autoriteti kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me inventar për nevojat e MPB-se” me numër prokurimi 214-25-11592-5-5-8, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

Udhëheqësi i Sekretariatit, duke u bazuar në faktet e prezantuara si dhe në ato që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund ti drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit te vendimit.

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - "Mobelland" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: